



Strategjia Kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda, 2021-2025

TABELA E PËRMBAJTJES

Lista e shkurtimeve	4
Misioni	6
Vizioni.....	6
1. Hyrje.....	7
2. Analiza e situatës	9
4. Zbatimi i strategjisë.....	21
4.1. Objektivi Strategjik 1: Ulja e kërcënimit dhe ndikimit të krimit të organizuar dhe krimeve të rënda	21
4.2. Objektivi Strategjik 2: Mbrojtja e qytetarëve, institucioneve dhe ekonomisë.....	26
4.3. Objektivi Strategjik 3: Parandalimi	29
5. Paraqitja tabelore e dokumentit strategjik	32
6. Zbatimi, monitorimi dhe vlerësimi	48
7. Burimet financiare	48
8. Përgjegjësia e institucioneve	48

Lista e shkurttimeve

AAPSK	Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara
AISM	Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes
AKCESK	Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike
AMF	Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare
AS	Akademia e Sigurisë
BE	Bashkimi Evropian
BKH	Byroja Kombëtare e Hetimit
BSH	Banka e Shqipërisë
DHKA	Dhoma Kombëtare e Avokatisë
DPB	Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve
DPD	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave
DPPPP	Drejtoria e Përgjithshme për Parandalimin e Pastrimit të Parave
DPPSH	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit
DVP	Drejtoritë Vendore të Policisë
DPT	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve
EMCDA	Qendra Evropiane e Monitorimit të Narkotikëve dhe Varësisë nga Droga
EMPACT	Platforma multidisiplinare evropiane kundër kërcënimeve kriminale
FAST	Njësia për Kapjen e Personave në Kërkim
FATF	Task Forca e Veprimit Financiar
GKO	Grupet e krimit të organizuar
KLP	Këshilli i Lartë i Prokurorisë
KLJG	Këshilli i Lartë Gjyqësor
MASR	Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë
MB	Ministria e Brendshme
MBZHR	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
MD	Ministria e Drejtësisë
MEPJ	Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
MK	Ministria e Kulturës
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
NSPK/SPZ	Ndihmës specialist i policimit në komunitet
PP	Prokuroria e Përgjithshme
PSH	Policia e Shtetit

QEDH	Qendra për Ekstremizmin e Dhunshëm
QKB	Qendra Kombëtare e Biznesit
SKZHI	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim
SIENA	Aplikacioni i sigurt i rrjetit të shkëmbimit të informacionit
SKKOKR	Strategjia kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda
SHISH	Shërbimi Informativ i Shtetit

Misioni

“Mbrotjtja e qytetarëve dhe zhvillimit të vendit nga kërcënimet dhe ndikimi i krimit të organizuar dhe krimeve të rënda, përmes zvogëlimit të risqeve dhe rritjes së parandalimit.”

Vizioni

“Garantimi i një mjedisi të sigurt për zhvillimin e vendit dhe shoqërisë nga kërcënimet e krimit të organizuar dhe krimeve të rënda, duke siguruar jetën e individit, sipërmarrjen e lirë dhe respektimin e ligjshmërisë në tërësi.”

1. Hyrje

Strategjia Ndërsektorale Kundër Krimin të Organizuar dhe Krimeve të Rënda është hartuar në vijim të dy strategjive të mëparshme: Strategjisë Ndërsektorale të Luftës kundër Krimin të Organizuar, Trafikeve të Paligjshme dhe Terrorizmit 2008-2013 dhe Strategjisë Ndërsektorale të Luftës kundër Krimin të Organizuar, Trafikeve të Paligjshme dhe Terrorizmit 2013-2020. Ndryshe nga dokumentet e mëparshëm kjo strategji përqëndrohet në luftën kundër krimin të organizuar dhe krimeve të rënda, duke u fokusuar në komponentët kryesorë të saj si: **trafikimi i drogave, njerëzve, armëve, veprave të artit dhe trashëgimisë kulturore, pastrimi parave, krimi kibernetik dhe strukturat e organizuara kriminale.**

Zhvillimi i strategjisë i është nënshtruar një procesi konsultativ ndërmjet institucioneve shtetërore të përfshira në luftën kundër krimin të organizuar dhe krimeve të rënda, të cilat do të japin kontributin kryesor në zbatimin e kësaj strategjie dhe monitorimin e ecurisë së saj.

Strategjia bazohet mbi të dhëna dhe vlerësime të institucioneve dhe agjencive të zbatimit të ligjit dhe inteligjencës, si dhe raporte të jashtme vlerësimi të institucioneve ndërkombëtare dhe vendore.

Procesi i hartimit të strategjisë ka kaluar nëpër disa faza:

Faza e parë ka konsistuar në vlerësimin e kërcënimit nga krimi i organizuar, duke u mbështetur në matjen e rezultateve të arritura gjatë zbatimit të Strategjisë Ndërsektorale të Luftës kundër Krimin të Organizuar, Trafikeve të Paligjshme 2013-2020. Nëpërmjet këtij vlerësimi janë identifikuar mangësitë dhe nevojat në qasjen e deritanishme kundër krimin të organizuar dhe krimeve të rënda, mbi të cilat janë zhvilluar gjatë fazës së dytë objektivat strategjike, qëllimet, objektivat specifike të strategjisë, si dhe treguesit e performancës për të matur arritjet. Pjesë përbërëse e këtij vlerësimi kanë qenë dhe gjetjet dhe rekomandimet e ofruara nga raportet e pavarura ndërkombëtare dhe ato vendore, të cilat kanë trajtuar vit pas viti çështje që lidhen me zbatimin e ligjit dhe luftën kundër krimin të organizuar në Shqipëri. Gjithashtu, një sërë dokumentesh strategjike dhe praktikash të mira ndërkombëtare në këtë fushë janë konsultuar dhe kanë shërbyer për fazën tre dhe katër të këtij procesi. Gjatë fazës së e tretë është kryer hartimi i dokumentit përfundimtar dhe hartimi i Planit të Veprimit për zbatimin e strategjisë për periudhën 2021-2022 ndërsa gjatë fazës së katërt është kryer procesi i konsultimit me publikun dhe palët e interesuara.

Kapitujt në vijim të këtij dokumenti strategjik do të trajtojnë një sërë çështjesh që lidhen me hapat që janë ndjekur për të arritur këtë strategji, synimet dhe pritshmëritë e saj, si dhe zbatimin dhe monitorimin e objektivave të përcaktuara.

Në pjesën e parë të këtij dokumenti do të pasqyrohet një vlerësim i përgjithshëm i përpjekjeve, arritjeve dhe sfidave në luftë kundër krimit të organizuar dhe krimeve të rënda në vend, duke u mbështetur në analizat e brendshme të institucioneve shqiptare, si dhe duke u referuar në raportet kryesore të institucioneve dhe organizmave ndërkombëtare, që mbulojnë këto çështje. Pjesa e dytë fokusohet në qasjen strategjike që do të ndiqet në këtë dokument, ndërsa pjesa e tretë pasqyron mënyrën se si vizioni dhe synimet e strategjisë do të përkthehen në veprimtari konkrete nëpërmjet objektivave strategjike, qëllimeve, objektivave specifike dhe indikatorëve.

Së fundmi, pjesa e katërt përcakton përgjegjësitë dhe fushat e zbatimit nga institucionet e përfshira, si dhe trajton çështjen e zbatimit dhe monitorimit.

2. Analiza e situatës

Krahas vlerësimeve periodike të kryera nga institucionet shqiptare, organizma ndërkombëtare, të pavarura dhe të paanshme, raportojnë se “*Shqipëria ka bërë përparim të mirë në forcimin e luftës kundër krimit të organizuar... dhe rezultate të prekshme janë arritur në këtë drejtim*”¹. Sipas Komisionit Evropian, përparimi i bërë në këtë drejtim nga vendi ynë dëshmohet përmes *intensifikimit të mëtejshëm të operacioneve policore për shkatërrimin e grupeve kriminale...dhe angazhimit të fortë për të shkatërruar trafikimin e drogës.*”²

Ndër faktorët kyç që kanë çuar në një numër të konsiderueshëm të operacioneve të suksesshme dhe arrestimin e drejtuesve të grupeve të organizuara kriminale, përmenden bashkëpunimi me vendet anëtare të BE dhe Europol, rritja e bashkëpunimit midis policisë dhe prokurorisë, zbatimi i *acuqis* të BE-së në këtë fushë, përmbushja e rekomandimeve të vazhdueshme, si dhe zbatimi i Planit të Veprimit për adresimin e kërkesave të FATF. Një vëmendje e posaçme i është kushtuar gjithashtu rëndësisë dhe rolit të institucioneve të reja të drejtësisë, konkretisht Zyrës së Prokurorisë së Posaçme. Vijimi i zbatimit të reformës në drejtësi dhe punës për luftën kundër krimit të organizuar, vlerësohen të një rëndësie jetike nga Departamenti Amerikan i Shtetit.³

Për sa i përket rezultateve në luftën kundër narkotikëve, raportohet se “*ashtu si vitet e kaluara, Shqipëria dëshmoi gjithashtu në 2019 një përkushtim të fortë dhe të qëndrueshëm në luftën kundër prodhimit dhe trafikimit të kanabisit*”. Faktorë kyç në këtë drejtim përmenden lejimi i monitorimit ajror nga Guardia di Finanza italiane, bashkëfinancuar nga BE, puna e ekipeve të përbashkëta të hetimit dhe operacionet në shkallë të gjerë në lidhje me kokainën dhe heroinën në bashkëpunim me autoritetet policore të vendeve fqinje, veçanërisht me Italinë, të cilat kanë ndihmuar në identifikimin dhe ndjekjen penale të organizatave kriminale gjatë operacioneve të trafikimit të narkotikëve, përfshirë ato të kryera nga deti. Si rezultat i këtyre operacioneve, janë rritur gjithashtu sekuestrimet e sasive të hashashit. Komisioni Evropian, në raportin e tij të vitit 2020 mbi vendin tonë vlerësoi gjithashtu vazhdimin e bashkëpunimit me Qendrën Evropiane të Monitorimit të Narkotikëve dhe Varësisë nga Droga (EMCDDA), mbështetur dhe në marrëveshjen e punës të nënshkruar në muajin mars 2019, mes Shqipërisë dhe EMCDDA.

¹ EU Commission, Albania 2020 Report, Brussels, 6.10.2020 pg 6 https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/albania_report_2020.pdf

² Po aty

³ United States Department of State, International Narcotics Control Strategy Report, Albania 2020, pg 93, <https://www.state.gov/wp-content/uploads/2020/06/Tab-1-INCSR-Vol.-I-Final-for-Printing-1-29-20-508-4.pdf>

Faktorë të natyrës dhe bashkëpunimit ndërkombëtar, përfshi dhe përpjekjet e vendit për integrimin në Bashkimin Evropian janë vlerësuar me ndikim pozitiv në drejtim të rritjes së volumit të drogave të sekuestruara dhe numrit të arrestimeve lidhur me këto çështje gjatë vitit 2019, edhe nga Departamenti Amerikan i Shtetit. Ky i fundit, sjell në vëmendje se ndonëse roli i Shqipërisë si vend burimi dhe tregtimi i drogave kryesisht të forta mbetet i ulët, ka një rritje të sasive të sekuestruara të kokainës në Evropën Perëndimore me përfshirjen e grupeve kriminale shqiptare.

Krahas vazhdimit dhe forcimit të bashkëpunimit ndërkombëtar, duke përfshirë adresimin e tendencave të reja në fushën e trafikimit të lëndëve narkotike, nevojitet që autoritetet shqiptare të marrin masa shtesë të karakterit politik, legjislativ dhe organizativ. Ndër nevojat e identifikuara, përfshihen miratimi i strategjisë dhe planit kombëtar për drogat, rishikimi i legjislacionit mbi barnat narkotike dhe substancat psikotrope, përditësimi i listës së substancave të ndaluara psikoaktive dhe ngritja e Observatorit Kombëtar të Drogave dhe Sistemit të Paralajmërimit të Hershëm për substancat e reja psikoaktive.

Referuar sfidave, rezultateve të arritura dhe rekomandimeve për forcimin e luftës kundër trafikëve të paligjshme, vendi ynë vijon të raportohet si një vend burimi, tranziti dhe destinacioni për trafikimin e qenieve njerëzore. Viktimat përfshijnë gra dhe fëmijë të cilët i nënshtrohen trafikimit për shfrytëzim seksual dhe të punës, në vendet fqinje dhe shtetet anëtare të BE-së.

Shqipëria ka forcuar përpjekjet për parandalimin dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit dhe ka vijuar masat për zbatimin e ligjit.⁴ Në dhjetor 2019, Shqipëria miratoi masa shtesë për të parandaluar trafikimin e qenieve njerëzore, veçanërisht duke rritur kontrollimin e detajuar nga ana e Policisë së Shtetit për të miturit që largohen nga vendi. Mekanizmi kombëtar i referimit për viktimat (e mundshme) të trafikimit vlerësohet plotësisht funksional. Megjithatë, autoritetet shqiptare duhet të rrisin përpjekjet për identifikimin e hershëm të viktimave dhe viktimave të mundshme, intensifikimin e bashkëpunimit ndërkufitar me vendet fqinje dhe bashkëpunimin ndërkombëtar si dhe në riintegrimin e suksesshëm të viktimave. Vëmendje e veçantë duhet tu kushtohet fëmijëve të pashoqëruar dhe fëmijëve viktimë të trafikimit duke u siguruar atyre gjithashtu mbrojtjen e duhur.

⁴ United States Department of State, Trafficking in Persons Report, Albania 2020, <https://www.state.gov/reports/2020-trafficking-in-persons-report/albania/>

Referuar veprimtarisë së paligjshme të trafikimit të armëve, vendi ynë konsiderohet një vend tranzit dhe destinacion për armët e lehta. Shqipëria ka miratuar Strategjinë për Kontrollin e Armëve të Vogla, të Lehta, Municioneve dhe Eksplozivëve 2019–2024 dhe të Planin e Veprimit 2019–2021, si dhe ka marrë pjesë në mënyrë aktive në Ciklin e Politikave të BE - planin e veprimit operativ EMPACT mbi armët e zjarrit.

Objekte të tjera të veprimtarisë së paligjshme të trafikimit përfshijnë veprat e artit dhe të kulturës, mjetet motorike, etj. Institucionet dhe agjencitë ligjzbatuese shqiptare kanë kryer një sërë operacionesh me qëllim zbulimin, identifikimin, gjetjen e objekteve dhe hetimin e dënimit e autorëve të përfshirë në këto forma të trafikimit. Për shkak të rëndësisë madhore që ka ruajtja e veprave të trashëgimisë kulturore, objektiva dhe masa të detajuara janë parashikuar për zbatim nga institucione dhe agjenci të ndryshme ligjzbatuese në një Plan Veprimi të posaçëm, i cili plotëson dhe shoqëron këtë strategji.

Sipas vlerësimit të Task Forcës së Veprimit Financiar (FATF), Shqipëria ka ndërmarrë hapa në drejtim të forcimit të efektivitetit të regjimit të saj kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, duke përfshirë miratimin e legjislacionit për zbatimin e regjistrimit për pronarët përfitues, marrjen e masave për reduktimin e ekonomisë informale dhe përdorimin e cash dhe ngritjen e ekipeve të specializuara dhe zyrtarëve për hetimin dhe ndjekjen penale të pastrimit të parave, në çdo qark.⁵ Megjithëse Komisioni Evropian ka vlerësuar një lloj progresi lidhur me sekuestrimet dhe konfiskimet e pasurive kriminale, numri i çështjeve me dënime përfundimtare për pastrim parash mbetet i ulët. Krahas vijimit të zbatimit të Planit të Veprimit të dakordësuar me Task Forcën e Veprimit Financiar për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, nevojiten përpjekje për të forcuar hetimet financiare dhe luftën kundër pastrimit të parave. Një vëmendje e shtuar i duhet kushtuar identifikimit dhe konfiskimit të pasurive kriminale të vendosura jashtë vendit ose të paarrtshme, zbatimit të rregullave për konfiskimin e zgjeruar dhe ngrirjen paraprake të pasurive, si dhe përdorimit sistematik të hetimeve paralele financiare për krimin e organizuar, të cilat duhet të shoqërojnë sistematikisht procedimet penale që nga fillimi.

Megjithë përpjekjet e bëra dhe rezultatet e arritura deri më tani, institucionet dhe agjencitë përgjegjëse duhet të rrisin efektivitetin e zbatimit të ligjit në fushën e krimeve kibernetike.

⁵ Financial Action Task Force (FATF), Albania <http://www.fatf-gafi.org/countries/d-i/iceland/documents/increased-monitoring-october-2020.html>

Zbulimi, gjurmueshmëria dhe ndjekja penale e kriminelëve në internet dhe adresimi i fenomenit në rritje të pedo-pornografisë në internet duhet të jenë në fokus të veprimtarisë së strukturave përkatëse., kapacitetet e të cilave kanë nevojë për përmirësim. Në veçanti, Shqipëria duhet të miratojë ndryshimet e nevojshme legjislative për të penalizuar të gjitha format e abuzimit seksual të fëmijëve në internet.

Çdo vit, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit kryen një vlerësim kombëtar të kërcënimit të krimit të organizuar dhe krimeve të rënda, duke përfshirë vlerësimin e riskut të grupeve kriminale në mënyrë që të ketë një panoramë të krimit dhe kërcënimeve me të cilat përballet dhe të vendosë për masat operacionale për adresimin e tyre. Institucione dhe agjenci të tjera ligjzbatuese mbledhin, hartojnë dhe shkëmbejnë të dhëna dhe informacione rreth veprimtarisë së paligjshme të krimit të organizuar dhe krimeve të rënda, mbështetur në fushën e veprimit dhe përgjegjësitë e tyre ligjore.

Bashkëpunimi policor me Shtetet Anëtare të BE dhe Europol është intensifikuar, duke çuar në një numër të konsiderueshëm të operacioneve të suksesshme dhe arrestimin e drejtuesve të grupeve të strukturuar kriminale. Agjencitë shqiptare të zbatimit të ligjit përdorin marrëveshjen operacionale me Europol, përmes shkëmbimit proaktiv dhe në kohë të informacionit përmes SIENA, si dhe përdorin ekipe të përbashkëta hetimore për të kryer hetime me homologët e BE-së.

Shqipëria merr pjesë gjithashtu në projektet e analizave operacionale të Europol si dhe në Projekte Analizash lidhur me krimin kibernetik, krimin mjedisor, krimin e organizuar për pasuritë, terrorizmin, kontrabandën e migrantëve, trafikimin e qenieve njerëzore, armët dhe eksplozivët. Zyra Ndërlidhëse e Europol në Shqipëri, e hapur zyrtarisht në muajin korrik 2019, ishte e para që operoi në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Vendi ynë ka shkëmbyer gjithnjë e më shumë informacion me Europol dhe u bashkua me Rrjetin Operacional Informal kundër Pastrimit të Parave në vitin 2019, si dhe u bë një partner strategjik në 'krimin e organizuar të pronës', një nga fushat me përparësi të hetimit të krimit të Europol, dhe një prioritet për sa i takon Platformës Evropiane Multidisiplinare kundër Kërcënimeve Kriminale (EMPACT).

Komisioni Evropian ka vlerësuar në vitin 2020 se numri dhe cilësia e mesazheve të shkëmbyera përmes aplikacionit të sigurt të rrjetit të shkëmbimit të informacionit (SIENA) është përmirësuar ndjeshëm që nga fundi i vitit 2019 dhe se ka patur zhvillime pozitive në bashkëpunimin me Interpol. Hapja në muajin korrik 2019 dhe funksionimi i Zyrës Ndërlidhëse të Europol në

Shqipëri, e cila ishte e para zyrë që operoi në rajonin e Ballkanit Perëndimor dhe roli i Oficerit Ndërlidhës në Tiranë ndihmuan në forcimin e mëtejshëm të bashkëpunimit policor me Europol dhe vendet anëtare. Për më tepër, Shqipëria ka vijuar të bashkëpunojë mirë në çështjet penale, përfshirë vendet anëtare të BE-së. Marrëveshja e saj e bashkëpunimit me Eurojust, e cila hyri në fuqi në 1 nëntor 2019, pritet të lehtësojë më tej bashkëpunimin gjyqësor autoriteteve shqiptare dhe atyre të BE në luftën kundër krimit të organizuar ndërkombëtar. Megjithatë, duhet të përmirësohet më tej bashkëpunimi juridiksional ndërkombëtar, zbatimi në kohë i instrumenteve shumëpalëshe dhe kapaciteti institucional. Këto përpjekje duhet të shoqërohen nga përpjekjet e mëtejshme për të harmonizuar legjislacionin me acquis të BE dhe për të nxitur shkëmbimin e praktikave më të mira në bashkëpunimin gjyqësor.

Në nëntor të vitit 2017, qeveria shqiptare mori vendim për krijimin e operacionit “Forca e Ligjit”. ‘Forca e Ligjit’ u konceptua si një strukturë e vecantë brenda Policisë së Shtetit me oficerë të dedikuar për luftën ndaj krimit të organizuar. Një nga detyrat e para të ‘Forcës së Ligjit’ ishte krijimi i një harte të saktë mbi grupet e krimit të organizuar, fushën e tyre të veprimtarisë, ndikimin në territor, identifikimin e udhëheqësve, anëtarëve, financuesve, aseteve dhe aktiviteteve financiare të pastrimit të produkteve të krimit. Pas kësaj pune paraprake, në gati tri vite, Operacioni “Forca e Ligjit” ka arritur një sërë rezultatesh konkrete nëpërmjet operacioneve policore të kryera, të cilat kanë çuar në arrestimin e një numri të konsiderueshëm të anëtarëve të grupeve kriminale dhe sekuestrimin e aseteve të tyre me vlerë rreth 120 milionë Euro.

Në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë, në muajin korrik 2019 u krijua Njësia për Kapjen e Personave në Kërkim (Fugitive Active Searching Team) “Fast Albania”. Në shkurt të vitit 2020 kjo njësi u bë pjesë e rrjetit europian ENFAST, duke u bërë kështu vendi i parë në Ballkanin Perëndimor, jo antëar i BE që ka krijuar një njësi të tillë të specializuar. Njësia është e fokusuar në kapjen e personave të rrezikshëm në kërkim dhe në bashkëpunim me njësitë simotra të BE dhe deri në muajin shtator 2020 , ka kontribuar në kapjen e 22 shumë të kërkuarve, të huaj apo shqiptarë, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

Sa i përket krijimit të institucioneve të reja, si rezultat i reformës së sistemit të drejtësisë u krijua një gjykatë e veçantë (GJKKO), një prokurori e veçantë (SPAK) dhe një njësi e hetimore e veçantë (BKH) sipas modelit amerikan të FBI. Të tre këto institucione kanë objektiv kryesor

luftën ndaj krimit të organizuar dhe korrupsionit, kanë një legjislacion të vecantë për organizimin dhe funksionimin, janë totalisht të pavaruara nga organet e tjera të kontrollit të sistemit të drejtësisë dhe operojnë vetëm në bazë të Kushtetutës dhe ligjit të tyre të organizimit. Kjo formë e re organizimi dhe funksionimi ka eliminuar një problem serioz të hasur ndër vite, atë të varësisë funksionale dhe organizative nga hallkat qeverisëse të sistemit të drejtësisë. Të tri këto institucione përbëhen nga gjyqtarë, prokurorë dhe hetues që i janë nënshtruar paraprakisht një procesi ri-vlerësimi (vetting), sa i përket figurës, pasurisë dhe profesionalizmit. Qëllimi është që lufta ndaj korrupsionit dhe krimit të organizuar të cohet përpara nga gjyqtarë, prokurorë dhe hetues të ndershëm dhe të aftë.

Duke qenë se krijimi i institucioneve të veçanta, sidomos i njësisë speciale të hetimit (BKH) kërkonte kohë për t'u realizuar, qeveria shqiptare ndërmori disa masa të menjëhershme për të asistuar institucionet e sistemit të drejtësisë në luftën nga krimit të organizuar dhe korrupsionit.

Një rëndësi e vecantë iu kushtua legjislacionit në dispozicion të institucioneve dhe agjencive ligjzbatuese. Në luftën ndaj krimit të organizuar institucionet dhe agjencitë përdorin jo vetëm legjislacionin penal por edhe forma të tjera edhe më proaktive sic është legjislacioni parandalues.

Shqipëria ka një traditë në adoptimin e legjislacionit parandalues që në vitin 2004 me miratimin e ligjit të parë të ashtuquajtur *anti-mafia* sipas modelit italian. Pavarësisht ndryshimeve të shpeshta në vite, thelbi i këtij legjislacioni nuk kishte ndryshuar, ai ka qenë i përqendruar vetëm mbi ato që quhen masa pasurore, pra sekuestrimi dhe konfiskimi i të mirave dhe aseteve i personave të përfshirë në aktivitete kriminale.

Në 31 janar 2020, me iniciativë të qeverisë, ky legjislacion u kompletua nëpërmjet adoptimit të Akti Normativ Nr.1, “Për masat parandaluese në kuadër të forcimit të luftës kundër terrorizmit, krimit të organizuar, krimeve të rënda dhe konsolidimit të rendit e sigurisë publike”.

Legjislacioni i ri akoma edhe më agresiv, parashikoi krahas masave pasurore ekzistuese të sekuestrimit dhe konfiskimit, masa parandaluese personale si mbikëqyrja speciale e personave apo masa ekonomike si ndalimi i marrjes pjesë të ndërmarrjeve të caktuara private në tendera publike apo koncesione.

Ky legjislacion ofroi një instrument akoma edhe më efikas në duart e institucioneve dhe agjencive ligjzbatuese shqiptare sepse mundësoi një aksion të koordinuar dhe kompleks ndaj kriminit të organizuar përmes zbatimit të masave parandaluese personale, masave parandaluese pasurore si sekuestrimi apo konfiskimi i aseteve mundësojnë kufizimin e fuqisë financiare të individëve apo grupeve kriminale, si dhe masave ekonomike, si heqja e licencave apo lejeve apo ndalimi i marrjes pjesë në tendera publike të shoqërive tregtare, të cilat mundësojnë kufizimin e injektimit të parave kriminale në ekonomi.

3. Qasja strategjike kundër krimit të organizuar dhe krimeve të rënda

Lufta ndaj krimit të organizuar dhe krimve të rënda përbën një nga prioritetet kryesore të qeverisë shqiptare dhe Ministrisë së Brendshme, si dhe është një ndër kriteret kryesore për procesin e anëtarësimit të vendit në BE. Konsolidimi i shtetit të së drejtës dhe rritja e sigurisë në vend janë të lidhura ngushtësisht me rritjen e kapaciteteve njerëzore dhe logjistike në institucionet ligjzbatuese, përmirësimin e kuadrit ligjor, përmirësimin cilësisë së hetimore dhe forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe ndërkombëtar.

Kjo strategji dhe plani i veprimit që e shoqëron mbështetet në vizionin e qeverisë për mbrojtjen e qytetarëve dhe përparimit të vendit nga kërcënimet dhe ndikimi i krimit të organizuar dhe krimet të rënda, përmes zvogëlimit të risqeve dhe rritjes së fuqisë parandaluese.

Ky dokument do të jetë një udhërrëfyes për zbatimin në praktikë të qasjes gjithëpërfshirëse kundër veprimtarive të paligjshme dhe strukturave të krimit të organizuar, e cila përfshin ndërveprimin midis qeverisë, sektorit privat, komunitetit dhe qytetarëve për këtë qëllim.

Prioritetet, objektivat dhe masat konkrete që parashikon kjo strategji, organizohen dhe synojnë të adresojnë tre çështje kryesore në përballje me krimin e organizuar dhe krimet e rënda: (1)

Goditja (*pursue*), (2) **Parandalimi** (*prevention*), (3) **Mbrojtja** (*protection*).

Me gjithë përparimin e bërë, sfida kundër krimit të organizuar dhe krimeve të rënda mbetet e madhe dhe për këtë arsye kjo strategji e rishikon qasjen në përballjen me të. Duke marrë në konsideratë natyrën komplekse dhe gjithmonë në zhvillim të strukturave, veprimtarive dhe formave të shfaqjes së krimit të organizuar, në themel të kësaj strategjie parashikohet një qasje gjithëpërfshirëse e gjithë shoqërisë shqiptare kundër këtij fenomeni ku institucionet shtetërore, sektori privat, komunitetet dhe qytetarët të luajnë rolin e tyre në një përpjekje kolektive për të ulur kërcënimin dhe ndikimin e krimit të organizuar. Për të realizuar këtë qëllim, Strategjia Ndërsektoriale kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2021 – 2025 parashikon tre objektiva strategjike:

1. Ulja e kërcënimit dhe ndikimit të krimit të organizuar dhe krimeve të rënda.

Me qëllim të uljes së kërcënimit të krimit të organizuar dhe krimeve të rënda, nevojitet adresimi njëkohësisht i shqetësimeve kryesore që lidhen me veprimtaritë e paligjshme të krimit të organizuar, sidomos atyre në fushën e narkotikëve dhe trafiqeve të paligjshme, shfrytëzimi i hapësirës dhe infrastrukturës kibernetike për qëllime kriminale, si dhe veprave penale në fushën

e krimit ekonomik dhe pastrimit të parave. Sigurisht, goditja dhe ndjekja e strukturave të krimit të organizuar, të cilat vepronë brenda apo jashtë vendit është me rëndësi kritike për zbatimin efektiv të këtij objektivi strategjik.

Përmbushja me efektivitet i objektivave të mësipërm do të mbështetet përmes vënies në përdorim të kapaciteteve dhe aftësive të reja për dobësimin e përhapjes dhe ndikimit të krimit të organizuar dhe krimeve të rënda, duke përmirësuar sistemet, kuadrin ligjor, burimet njerëzore dhe nivelin e bashkëpunimit dhe koordinimit të institucioneve dhe aktorëve vendas me përgjegjësi dhe rol në këtë fushë. Për më tepër, një vëmendje e veçantë do t'i kushtohet nevojës për forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar, kapjes dhe vënies përpara drejtësisë të personave në kërkim kombëtar dhe ndërkombëtar dhe zbatimit të regjimit të posaçëm në burgun e sigurisë së lartë për subjektet me rrezikshmëri të theksuar kriminale.

Lufta kundër narkotikëve do të intensifikohet duke bashkërenduar angazhimin e institucioneve ligjzbatuese me atë të vendeve partnere, si dhe do të ndërmerren procese të thella reformuese që do të prekin legjislacionin, logjistikën dhe personelin e institucioneve.

Në themel të kësaj qasje do të jenë mbledhja dhe analizimi i të dhënave të reja, rritja e aftësive informative dhe të vlerësimit, të cilat do t'i mundësojnë institucioneve të zbatimit të ligjit dhe qeverisë të kuptojë më mirë organizimin dhe veprimtarinë e rrjeteve të krimit të organizuar, avantazhet dhe dobësitë e tyre me qëllim realizimin e goditjeve sa më efektive. Për shkak se grupet dhe rrjetet kriminale shqiptare tashmë operojnë në një kontekst pothuaj tërësisht transnacional, edhe qasja gjurmuese dhe goditëse do t'i përshtatet kësaj prirje duke thelluar cilësisht bashkëpunimin me institucionet ligjzbatuese të vendeve Evropiane ku grupet shqiptare të krimit të organizuar operojnë.

Një vëmendje e veçantë i kushtohet gjithashtu uljes së kërcënimit që vjen nga veprimtaritë e paligjshme në fushën e trafikëve, duke përfshirë trafikimin e qenieve njerëzore, ndihmën për kalim të paligjshëm të kufirit apo e njohur ndryshe si kontrabandimi i migrantëve, trafikimi i armëve, municioneve dhe lëndëve plasëse, trafikimi i veprave të artit dhe kulturës, etj.. Krahas objektivave dhe masave të parashikuara në këtë dokument strategjik, masa dhe veprimtari shtesë do të parashikohen dhe ndiqen mbi bazë të planeve shoqëruese të veprimit.

Ulja e kërcënimeve nga veprat e paligjshme në fushën e krimit kibernetik përbën gjithashtu një objektivi të rëndësishëm të kësaj strategjie, e cila parashikohet të arrihet përmes forcimit të

kapaciteteve teknike dhe logjistike të strukturave përgjegjëse, rritjes së bashkëpunimit dhe pjesëmarrjes në platformat e përbashkëta ndërkombëtare në këtë fushë dhe masave dhe veprimtari të tjera shtesë të parashikuara me qëllim adresimin më të plotë dhe efektiv të këtij objekti.

Zbatimi i këtij objekti strategjik do të mbështetet gjithashtu përmes përmirësimit të proceseve të identifikimit, sekuestrimit dhe konfiskimit të financave dhe asetëve të grupeve kriminale. Kjo të ngushtojë hapësirën e veprimit, fuqisë financiare por dhe motiveve të përfshirjes në struktura të krimit të organizuar, si dhe pamundësimin e ri-investimit të të ardhurave të përftuara nga veprimtari të paligjshme.

Në funksion të hetimeve efektive, ndjekjes penale dhe dhënien e dënimeve përfundimtare për drejtuesit dhe anëtarët e grupeve të strukturuar kriminale dhe autorëve të krimeve të rënda, janë parashikuar një sërë masash konkrete me qëllim forcimin e bashkëpunimit policor ndërkombëtar, nëpërmjet nënshkrimit të marrëveshjeve, shkëmbimit të informacionit dhe kryerjes së operacioneve të përbashkëta. Krahas rritjes së bashkëpunimit rajonal dhe ndërkombëtar në nivel të agjencive të zbatimit të ligjit, strategjia parashikon dhe masa dhe veprimtari konkrete që synojnë forcimin e marrëdhënieve juridiksionale me autoritetet e huaja, duke përfshirë përdorimin e zgjeruar të mekanizmave ndërkombëtare si marrëveshjet e ekstradimit, letërporositë dhe transferimin e procedimeve penale dhe personave të dënuar.

2. Mbrojtja e qytetarëve, institucioneve dhe ekonomisë.

Si rezultat i veprimtarisë së krimit të organizuar dhe krimeve të rënda, ndër vite, shumë qytetarë kanë vuajtur pasojat e kësaj veprimtarie në forma të ndryshme, si trafikimi për qëllime prostitucioni apo pune të detyruar, zhvatja e vlerave monetare apo materiale, dëmtimi i pronës dhe pasurisë dhe deri në dëmtimin e shëndetit dhe humbjen e jetës. Anëtarët e strukturave të krimit të organizuar kanë shfaqur gjithashtu synimin dhe prirjen për veprime neutralizuese të punës së nëpunësve publikë, përfshirë institucionet e zbatimit të ligjit dhe organeve të drejtësisë, përmes formave të ndryshme të intimidimit dhe korrupsionit.

Për më tepër, krimi i organizuar ka ndikim negativ në ekonominë e ligjshme të një vendi. Nëpërmjet përfitimeve të mëdha monetare, grupet kriminale synojnë të kryejnë investime dhe depërtojnë në sektorë të ndryshëm të ekonomisë nëpërmjet formave të ndryshme të pastrimit dhe riciklimit të të ardhurave kriminale, prezantimin e praktikave gjysmë të ligjshme të biznesit dhe

krijimin e aktiviteteve të ligjshme për të mbuluar veprimtaritë e fshehta kriminale dhe origjinën e të ardhurave të përftuara prej tyre, dëmtimin e konkurrencës, etj. Për sa më sipër, ulja e kërcënimit dhe ndikimit negativ të krimit të organizuar mbi qytetarët, institucionet dhe ekonominë e ligjshme të vendit, si dhe mbrojtja e tyre nga këto kërcënime vlerësohet si objektiv strategjik i veçantë i Strategjisë Ndërsektoriale kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda.

Në këtë kuadër, janë planifikuar një sërë masash për garantimin e jetës dhe shëndetit të dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë, funksionarëve të drejtësisë, si dhe viktimave të krimit të organizuar dhe krimeve të rënda.

Ndërmarrja e masave për garantimin e integritetit të punonjësve në institucionet publike dhe agjencitë ligjzbatuese, aftësimin profesional dhe investimin në logjistikë, do të krijojë një terren më të përshtatshëm për institucionet tona me qëllim mbrojtjen ndaj krimit të organizuar dhe krimeve të rënda. Njëkohësisht, përmbushja e këtyre masave do të kontribuojë në adresimin më efektiv të synimeve të parashikuara në objektiv strategjik nr. 1 duke rritur efektivitetin e reagimit të institucioneve dhe agjencive ligjzbatuese ndaj veprimtarive dhe autorëve të krimit të organizuar dhe krimeve të rënda, falë përmirësimit të kapaciteteve profesionale, logjistike dhe garantimit të integritetit të ushtrimit të detyrës.

Për të zbutur efektet negative të ndikimit të krimit të organizuar në ekonominë e vendit, kjo strategji do të synojë analizimin dhe evidentimin e mangësive dhe nevojave për përmirësim në legjislacionin shqiptar, si dhe në rolin e institucioneve dhe agjencive ligjzbatuese. Në bazë të këtyre analizave, do të ndërmerren ndryshime dhe plotësime ligjore në funksion të masave mbrojtëse me karakter ekonomik dhe pasuror.

Strategjia Ndërsektoriale kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda do të ndjekë një qasje mbrojtëse ndaj individëve dhe bizneseve, duke forcuar rezistencën e shoqërisë në nivel lokal dhe kombëtar, si dhe duke ulur tolerancën ndaj veprimtarive të krimit të organizuar. Masa konkrete të parashikuara në këtë strategji synojnë dobësimin e motivit financiar për përfshirje në veprimtari të krimit të organizuar.

3. Parandalimi.

Strukturat dhe rrjetet e krimit të organizuar synojnë dhe angazhohen në mënyrë të vazhdueshme për të rekrutuar anëtarë të rinj për kryerjen dhe zgjerimin e mëtejshëm të veprimtarive kriminale.

Për shkak të vështirësive me karakter kryesisht social-ekonomik, aftësia e strukturave kriminale për të rekrutuar anëtarë të rinj ka qenë e lartë, siç dëshmojnë dhe të dhënat statistikore të shtrira në kohë, mbi profilin e autorëve të dënuar për veprimtari të tilla kriminale, si brenda dhe jashtë vendit.

Rritja e vetëdijësimin për risqet dhe pasojat e krimit të organizuar do të arrihet nëpërmjet realizimit të fushatave për ndërgjegjësimin e shoqërisë, të cilat do të nxisin bashkëveprimin ndërmjet institucioneve qendrore dhe vendore, shoqërisë civile, biznesit, medias dhe aktorëve të tjerë relevantë.

Një sfidë e veçantë në kuadër të kësaj strategjie do të jetë ofrimi dhe koordinimi i mbështetjes së brendshme dhe të huaj për zonat dhe komunitetet vulnerabël. Si hap të parë strategjia parashikon evidentimin dhe analizimin e këtyre zonave dhe komuniteteve, për të koordinuar dhe nxitur më pas vënien në jetë të programeve dhe projekteve sociale dhe financiare, me qëllim parandalimin e kriminalitetit.

4. Zbatimi i strategjisë

Strategjia Ndërsektoriale kundër Krimin të Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2011 – 2021 synon të adresojë në mënyrë më efektive dhe gjithëpërfshirëse fenomenin e krimin të organizuar dhe format e shfaqjes së krimeve të rënda, përmes përmbushjes së tre objektivave kryesore strategjike:

- *Objektivi Strategjik 1: Ulja e kërcënimit dhe ndikimit të krimin të organizuar dhe krimeve të rënda*
- *Objektivi Strategjik 2: Mbrojtja e qytetarëve, institucioneve dhe ekonomisë*
- *Objektivi Strategjik 3: Parandalimi*

4.1. Objektivi Strategjik 1: Ulja e kërcënimit dhe ndikimit të krimin të organizuar dhe krimeve të rënda

Ky objektivi strategjik mbështetet mbi nevojën për adresimin më efektiv të veprimtarive të paligjshme të krimin të organizuar dhe krimeve të rënda, si dhe të autorëve të tyre. E njohur ndryshe si qasja goditëse (*pursue*), ndjekja dhe goditja e suksesshme e veprimtarive të paligjshme të krimin të organizuar dhe krimeve të rënda, si dhe vënia përpara përgjegjësisë dhe dënimi i autorëve mund të sigurohet vetëm mbi bazë të koordinimit dhe bashkëpunimit të të gjithë agjencive të zbatimit të ligjit, shërbimeve të inteligjencës dhe organeve të drejtësisë. Bashkëpunimi i institucioneve dhe agjencive brenda vendit me ato homologe të vendeve të tjera vlerësohet kritik në përmbushjen sa më të plotë të këtij objektivi strategjik. Veprimtaritë kryesore të krimin të organizuar dhe krimeve të rënda, të cilat marrin vëmendje të posaçme nga institucionet dhe agjencitë e ngarkuara me zbatimin e këtij dokumenti strategjik, përfshijnë:

- Veprimtari të paligjshme në fushën e narkotikëve;
- Trafikët e paligjshme, përfshi trafikimin e njerëzve, ndihmën për kalim të paligjshëm të kufirit (kontrabanda e migrantëve), trafikimi i armëve, municioneve dhe lëndëve plasëse dhe trafikimi i veprave të artit dhe kulturës;
- Krimi kibernetik;
- Krimi ekonomik dhe pastrimi i parave.

Ulja e kërcënimeve dhe ndikimit negativ që shkaktohet nga veprimtari të paligjshme në fushën e narkotikëve do të mbështetet në realizimin e objektivave dhe masave të mëposhtme:

- Rritja e veprimtarisë zbuluese të udhëhequr nga inteligjenca dhe evidencat;
- Përditësimi i bazës së të dhënave të posaçme për kultivimin e kanabisit me informacione nga të gjitha burimet e mundshme vendëse dhe të huaja;
- Planifikimi, organizimi dhe realizimi i takimeve, analizave dhe operacioneve të përbashkëta me qëllim të rritjes së zbulimit, hetimit, ndjekjes penale, dënimit dhe sekuestrimit në këtë drejtim;
- Forcimi i kontrollit kufitar për parandalimin dhe goditjen e trafikimit ndërkombëtar të drogave;
- Rritja e efikasitetit të bashkëpunimit me partnerët në drejtim të zbulimit të veprimtarive të paligjshme dhe goditjes së strukturave kriminale;
- Përmirësimi i kuadrit legjislativ për substancat psikotrope dhe prekursorët dhe përditësimi i listës së substancave të ndaluara psikoaktive;
- Përmirësimi i kuadrit legjislativ mbi procedurën e asgjësimit të lëndëve narkotike dhe prekursorëve dhe ruajtjes së mostrave.

Ulja e kërcënimeve dhe ndikimit negativ që shkaktohet nga veprimtari të trafiqeve të paligjshme do të mbështetet në realizimin e objektivave dhe masave të mëposhtme:

- Rritja e veprimtarisë zbuluese ndaj trafiqeve të paligjshme të udhëhequr nga inteligjenca dhe evidencat;
- Planifikimi, organizimi dhe realizimi i takimeve, analizave dhe operacioneve të përbashkëta me qëllim rritjen e zbulimit, hetimit, ndjekjes penale, dënimit, sekuestrimeve dhe konfiskimeve në këtë drejtim;
- Forcimi i bashkëpunimit me partnerët në drejtim të zbulimit të veprimtarive të paligjshme të trafiqeve dhe goditjes së strukturave kriminale të përfshira në këto veprimtari;
- Përmirësimi dhe miratimi i procedurave dhe mekanizmave standard kundër trafikimit të armëve të vogla dhe të lehta;
- Hartimi dhe miratimi i Planit të Veprimit kundër Trafikimit të Veprave të Artit dhe Kulturës;

- Ngritja dhe funksionimi i Task Forcës Ndërinstitucionale për Ruajtjen e Trashëgimisë Kulturore;
- Rishikimi i legjislacionit të brendshëm dhe ndryshimi në përputhje me instrumentet ndërkombëtare në fushën e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore.

Ulja e kërcënimeve dhe ndikimit negativ që shkaktohet nga veprimtari të paligjshme të krimit kibernetik do të mbështetet në realizimin e objektivave dhe masave të mëposhtme:

- Hartimi dhe miratimi i Planit të Veprimit kundër krimit kibernetik;
- Vlerësimi dhe përafrimi i legjislacionit me *acquis* të BE, standardet dhe praktikat më të mira ndërkombëtare;
- Funksionimi dhe rritja e kapaciteteve logjistike dhe teknike të njësisë së specializuar për hetimin e krimeve kibernetike;
- Rritja e kapaciteteve logjistike dhe teknike në nivel lokal për hetimin e krimeve kibernetike;
- Pjesëmarrja aktive përmes pikave të kontaktit në platformat ndërkombëtare, përfshi rritjen e numrit dhe cilësisë së mesazheve të shkëmbyera me Europol;
- Rritja e ndërgjegjësimit midis prokurorëve mbi format e krimit kibernetik dhe përdorimin e rrjetit të pikave të kontaktit të Këshillit të Evropës.

Ulja e kërcënimeve dhe ndikimit negativ që shkaktohet nga veprimtari të krimit ekonomik dhe pastrimit të parave do të mbështetet në realizimin e objektivave dhe masave të mëposhtme:

- Zbatimi i masave të Planit të Veprimit në kuadër të rekomandimeve të ICRG/FATF;
- Forcimi i kapaciteteve të specializuara qendrore dhe vendore për hetimin e krimit ekonomik dhe financiar, duke përfshirë kryerjen e trajnimeve të përbashkëta;
- Sigurimi i aksesit dhe ndërveprimi online i bazave të të dhënave në funksion të mbikëqyrjes dhe hetimit në fushën ekonomike-financiare;
- Koordinimi dhe bashkëpunimi ndërinstitucional me qëllim rritjen e numrit të informacioneve të shkëmbyera mes strukturave përgjegjëse dhe kryerjen e analizave të thelluara mbi risqet e pastrimit të parave dhe administrimin e të dhënave (*track record*);
- Përmirësimi i zbatimit të sanksioneve financiare të targetuara dhe rritja e hetimeve

financiare proaktive dhe paralele që nga fillimi i procedimeve penale;

- Rritja e sekuestrimeve dhe konfiskimeve mbështetur në inteligjencë dhe hetime cilësore të thelluara;
- Rishikimi dhe miratimi i kuadrit legjislativ mbi gjurmimin, sekuestrimin, konfiskimin dhe rikuperimin e produkteve të krimit të organizuar;
- Menaxhimi i pasurive të sekuestruara dhe konfiskuara duke ruajtur vlerën ekonomike të tyre.

Në funksion të hetimit penal dhe dënimit të drejtuesve dhe anëtarëve të strukturave të organizuara kriminale do të ndiqen dhe zbatohen objektivat dhe masat e mëposhtme:

- Rritja e efikasitetit të hetimeve kundër strukturave të organizuara kriminale, sidomos drejtuesve dhe financuesve të veprimtarive kriminale;
- Rritja e kapaciteteve teknike dhe logjistike përmes takimeve, analizave trajnimeve të përbashkëta dhe investimeve në funksion të hetimeve të thelluara, cilësore dhe proaktive kundër strukturave kriminale;
- Zgjerimi i aksesit dhe ndërveprimi i bazave të të dhënave publike/private të aksesueshme nga autoritetet përgjegjëse dhe zhvillimi dhe përdorimi i zgjeruar i kapaciteteve analitike (*software*);
- Rritja e hetimeve ndaj metodave dhe rasteve të infiltrimit (korrupsioni, kërcënimet, etj) nga strukturat e krimit të organizuar;
- Përmirësimi i kuadrit legjislativ me qëllim rritjen e kapaciteteve të prokurorisë dhe agjencive të zbatimit të ligjit për luftën kundër kriminalitetit duke plotësuar rekomandimet e BE-së për sigurimin në kohë reale të të dhënave nga kompanitë telefonike.

Me qëllim të forcimit të mëtejshëm të bashkëpunimit ndërkombëtar midis agjencive të zbatimit të ligjit, si një element kyç për luftën e suksesshme kundër veprimtarive dhe anëtarëve të strukturave të organizuara kriminale, do të ndiqen dhe zbatohen objektivat dhe masat e mëposhtme:

- Rritja e shkëmbimit të informacionit me agjencitë ligjzbatuese të vendeve të rajonit dhe më gjerë mbi strukturat kriminale brenda dhe jashtë vendit;

- Pjesëmarrja aktive në Europol, Interpol dhe platformat rajonale të bashkëpunimit;
- Nënshkrimi dhe zbatimi i marrëveshjeve me vendet e tjera për shkëmbimin e të dhënave (gjurmë daktiloskopike, profile ADN, të dhëna automjetesh, rekorde kriminale, të dhëna financiare, etj);
- Rritja e operacioneve të përbashkëta policore kundër veprimtarive dhe strukturave kriminale.

Gjetja, gjurmimi, kapja dhe vënia përpara përgjegjësisë ligjore të personave në kërkim kombëtar dhe ndërkombëtar, krahas zbatimit të ligjit, përbën një aspekt të rëndësishëm të uljes së ndikimit dhe kërcënimeve të krimit të organizuar dhe krimeve të rënda, për vendin tonë dhe më gjerë. Për vazhdimin dhe forcimin e rezultateve të arritura deri më tani në këtë drejtim, do të ndiqen dhe zbatohen objektivat dhe masat e mëposhtme:

- Pjesëmarrja aktive në takimet dhe trajnimet e ENFAST;
- Rritja e shkëmbimit të të dhënave me vendet anëtare të ENFAST, Europol dhe Interpol;
- Rritja e numrit të shtetasve shqiptarë dhe të huaj në kërkim ndërkombëtar të lokalizuar dhe arrestuar;
- Publikimi dhe përditësimi i të dhënave të identitetit të personave në kërkim ndërkombëtar.

Me qëllim të forcimit të mëtejshëm të rezultateve të drejtësisë penale ndaj autorëve dhe veprimtarive të paligjshme të krimit të organizuar dhe krimeve të rënda, nevojitet përdorimi sa më i plotë i instrumenteve dhe mekanizmave ndërkombëtarë në nivel juridiksional. Për këtë qëllim, do të ndiqen dhe zbatohen objektivat dhe masat e mëposhtme:

- Rritja e marrëdhënieve juridiksionale me autoritetet e huaja;
- Përditësimi dhe aksesimi në regjistrin gjyqësor penal të shtetasve shqiptarë të dënuar jashtë shtetit;
- Mbështetja dhe rritja e pjesëmarrjes në skuadrat e përbashkëta hetimore (JIT-s dypalëshe/Eurojust).

Një institut i rëndësishëm me karakter parandalues për vijimin e veprimtarive të paligjshme nga të burgosur dhe të paraburgosur për vepra që lidhen me krimin e organizuar, bashkëpunimit apo konflikteve të mundshme të tyre me subjekte të tjerë të krimit të organizuar, u prezantua për herë

të parë në vendin tonë përmes ligjit nr. 108/2018, i cili amendoi ligjin nr. 8328, datë 16.4.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve dhe të të parburgosurve”, të ndryshuar. Duke marrë në konsideratë kontributin që sjell në uljen e kërcënimit dhe ndikimit të krimit të organizuar dhe krimeve të rënda, kjo strategji thekson nevojën për:

- Zbatimin e regjimit të posaçëm në burgun e sigurisë së lartë për të parburgosur dhe të burgosur, për veprat penale në fushën e krimit të organizuar dhe krimeve të rënda.

Përbushja e objektivave dhe masave të mësipërme nga institucionet e përcaktuara si përgjegjëse dhe mbështetëse do të vlerësohet përmes indikatorëve të matshëm, sipas tabelës bashkëlidhur në fund të këtij seksioni.

4.2. Objektiv Strategjik 2: Mbrojtja e qytetarëve, institucioneve dhe ekonomisë

Ky objektiv strategjik mbështetet mbi nevojën për të ulur ndikimin dhe kërcënimet e krimit të organizuar dhe krimeve të rënda, mbi qytetarët, institucionet dhe ekonominë e ligjshme të vendit përmes ofrimit të mekanizmave mbrojtëse. E njohur në praktikë si qasja mbrojtëse (*protect*), masat e këtij objektiv strategjik kontribuojnë në luftën kundër krimit të organizuar, krahas zbatimit të qasjes goditëse, përmes forcimit të reagimit më të fortë dhe të sigurtë të institucioneve në bashkëpunim me qytetarët, në funksion dhe të sigurimit të integritetit të ekonomisë së ligjshme. Konkretisht, ky objektiv strategjik detajohet në objektivat e mëposhtme:

- Garantimi i sigurisë fizike dhe jetës
- Përmirësimi i kapaciteteteve profesionale dhe logjistike
- Dobësimi i motivit financiar për përfshirje në krim të organizuar (qasja administrative)

Për një luftë më efikase kundër krimit të organizuar dhe krimeve të rënda është e nevojshme që të garantohet, së pari, siguria fizike dhe e jetës së dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë, funksionarëve të drejtësisë dhe agjencive të zbatimi të ligjit, si dhe viktimave të krimit, përfshi ato të trafikimit. Për përbushjen e këtij objektiv duhet të zbatohen masat e mëposhtme:

- Garantimi i jetës dhe sigurisë fizike të dëshmitarëve, bashkëpunëtorëve të drejtësisë, funksionarëve të ngarkuar me luftën kundër krimit të organizuar dhe viktimave të trafikimit përmes programeve të posaçme;

- Nënshkrimi dhe zbatimi i marrëveshjeve ndërkombëtare mbi programet e mbrojtjes së dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë;
- Ofrimi i asistencës ndaj viktimave të trafikimit.

Goditja e veprimtarive të paligjshme dhe vënia përpara përgjegjësisë e autorëve të veprave të krimit të organizuar dhe krimeve të rënda mund të realizohet në mënyrë të plotë dhe efektive vetëm nga institucione dhe agjenci të zbatimit të ligjit të përbëra nga kapacitete profesionale me integritet, të cilët gjatë ushtrimit të detyrës i nënshtrohen vetëm ligjit dhe normave të etikës së institucionit apo organizatës ku ata bëjnë pjesë. Në përmbushje të këtij objekti janë parashikuar për ndjekje dhe zbatim masat e mëposhtme:

- Vijimi dhe raportimi mbi vlerësimin kalimtar të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat;
- Parandalimi, zbulimi dhe hetimi i veprave penale dhe shkeljeve të ligjit të kryera nga punonjësit e strukturave gjatë ushtrimit të detyrës dhe për shkak të saj dhe ruajtja e integritetit të punonjësve të veçantë të strukturave, ndaj të cilëve referohen ankesa dhe kallëzime;
- Kryerja e veprimtarive dhe marrja e masave në funksion të ruajtjes së integritetit të punonjësve të strukturave.

Përmirësimi i mëtejshëm dhe i vazhdueshëm i kapaciteteve profesionale përbën kusht për një përgjigje sa më efektive ndaj formave të ndryshme të shfaqjes së krimit të organizuar, përfshi ato më komplekse dhe zbulimin, hetimin dhe dënimin e autorëve të tyre, të cilët përdorin gjithnjë e më shumë metodat dhe taktika të zhvilluara për t'iu shmangur veprimtarisë zbuluese dhe hetimore të agjencive të zbatimit të ligjit, me synimin përfundimtar për t'iu shmangur përgjegjësisë penale. Për përmbushjen e këtij objekti kërkohet zbatimi i masave të mëposhtme:

- Kryerja e trajnimeve të strukturave të hetimit të krimit në Policinë e Shtetit mbi format dhe metodat më të avancuara të hetimit të strukturave dhe veprimtarive kriminale;
- Kryerja e trajnimeve të përbashkëta për punonjësit e agjencive të zbatimit të ligjit, shërbimeve inteligjente dhe funksionarëve të drejtësisë në funksion të hetimeve të thelluara dhe cilësore, ndjekjes penale, dënimit të autorëve dhe sekuestrimit/konfiskimit të produkteve dhe aseteve kriminale;

- Kryerja e trajnimeve për punonjësit e agjencive të zbatimit të ligjit, funksionarët e drejtësisë dhe stafet administrative për çështje të bashkëpunimit policor/gjyqësor ndërkombëtar;
- Kryerja e trajnimeve për punonjësit e agjencive të zbatimit të ligjit, gjyqtarëve dhe prokurorëve mbi rolin e viktimave në drejtësinë penale;
- Pranimi në Akademinë e Sigurisë i të diplomuarve që kanë përfunduar ciklin e dytë të arsimit të lartë.

Veprimtaria e institucioneve dhe agjencive të zbatimit të ligjit, krahas nevojës për kapacitete profesionale dhe me integritet, garanton rezultate më të gjera në luftë kundër fenomeneve të paligjshme kur mbështetet mbi infrastrukturën e nevojshme dhe të avancuar logjistike. Përmeshja e këtij objekti do të realizohet përmes zbatimit të masave të mëposhtme:

- Ngritja dhe funksionimi i Sistemit të Paralajmërimit të Hershëm (EWS) dhe Observatorit Kombëtar të Drogave;
- Magazinimi dhe asgjësimi i lëndëve narkotike dhe prekursorëve dhe ruajtja e mostrave si provë materiale për procedurat gjyqësore sipas standardeve dhe praktikave më të mira;
- Përmirësimi i bazës logjistike të Institutit të Policisë Shkencore dhe ofrimi i trajnimeve mbi ekzaminimet e lëndëve narkotike dhe prekursorëve;
- Hartimi i projekteve, përthithja e financimeve dhe koordinimi i projekteve për mbështetjen e kapaciteteve njerëzore, infrastrukurore dhe logjistike të agjencive të zbatimit të ligjit.

Mbrojtja e ekonomisë së ligjshme nga mundësitë dhe hapësirat e shfrytëzueshme nga strukturat e krimit të organizuar me qëllim të riciklimit të të ardhurave me origjinë kriminale, përbën një aspekt të rëndësishëm të qasjes mbrojtëse kundër kërcënimeve dhe ndikimit negativ të krimit të organizuar në shoqëri. Zbatimi në praktikë i qasjes administrative kundër krimit të organizuar ka rezultuar efikase për agjenci të ndryshme të zbatimit të ligjit. Ndjekja dhe forcimi i zbatimit të kësaj qasje në vendin tonë do të realizohet përmes masave të mëposhtme:

- Kryerja e një analize të plotë të legjislacionit, politikave dhe rolit të institucioneve dhe agjencive të zbatimit të ligjit në funksion të masave parandaluese me karakter ekonomik dhe pasuror;

- Evidentimi i mangësive dhe nevojave për përmirësim të kuadrit ligjor parandalues;
- Hartimi dhe miratimi i ndryshimeve ligjore dhe nënligjore në funksion të rritjes së parandalimit të investimit të të ardhurave kriminale në ekonomi;
- Kryerja e trajnimeve, analizave dhe koordinimi ndërinstytucional në zbatim të masave parandaluese pasurore;
- Rritja e aksesit dhe ndërveprimit në bazat e të dhënave publike dhe private për shqyrtimin e aplikimeve për leje, autorizime, licensa, etj.

4.3. Objektivi Strategjik 3: Parandalimi

Ky objektivi strategjik mbështetet mbi vizionin e qeverisë shqiptare për adresimin gjithëpërfshirës të fenomeneve të paligjshme, përfshi kërcënimet dhe ndikimin negativ të krimit të organizuar, duke mos u kufizuar vetëm në qasjen reaguese dhe goditëse. Qasja parandaluese (*prevent*) kërkon kohën e nevojshme dhe angazhimin e të gjithë aktorëve në shoqëri, përtej institucioneve shtetërore, për të ofruar rezultate të qëndrueshme dhe efektive në uljen e kërcënimeve dhe ndikimit të krimit të organizuar. Ky objektivi strategjik mbështetet në nevojën për rritjen e vetëdijësisë, ndjenjës së përgjegjësisë së përbashkët për sigurinë në komunitet, besimit të qytetarëve dhe bashkëpunimit të tyre me institucionet në përgjigje të përpjekjeve dhe formave të shfaqjes së veprimtarive të paligjshme. Gjithashtu, ofrimi i alternativave zhvillimore për komunitetet dhe zonat më të ndikuara dhe ekspozuara ndaj veprimtarive të paligjshme dhe përpjekjeve rekrutuese të strukturave të krimit të organizuar përbën njëkohësisht një aspekt me rëndësi kritike për zbatimin me sukses të qasjes parandaluese. Konkretisht, ky objektivi strategjik do të përmbushet përmes realizimit të objektivave të mëposhtme:

- Realizimi i fushatave për rritjen e ndërgjegjësisë me përfshirjen e institucioneve qendrore dhe vendore, shoqërisë civile, biznesit, medias dhe aktorëve të tjerë për parandalimin e krimit të organizuar;
- Ofrimi dhe koordinimi i mbështetjes së brendshme/huaj për zona dhe komunitete vulnerabël.

Në funksion të përmbushjes së objektivit të parë specifik të këtij objektivit strategjik, do të zbatohen masat e mëposhtme:

- Organizimi i fushatave ndërgjegjësuere në nivel qendror dhe vendor, me grupe të

targetuara dhe tema të përshtatura me kontekstin vendor lidhur me risqet, pasojat dhe parandalimin e përfshirjes në veprimtari kriminale;

- Organizimi i leksioneve dhe seminareve të hapura në mjedise arsimore publike dhe private;
- Realizimi i video-mesazheve ndërgjegjësuese mbi risqet dhe pasojat e krimit të organizuar si dhe promovimi i modeleve pozitive ndërmjet të rinjve dhe transmetimi në mediet lokale, rrjete sociale, etj;
- Organizimi i takimeve të Këshillave Vendorë për Siguri Publike me të ftuar nga shoqëria civile, të rinj, aktorë kyç në komunitete me fokus rritjen e vetëdijësimit ndaj krimit të organizuar.

Në funksion të përmbushjes së objektivit të dytë specifik të këtij objektivit strategjik, do të zbatohen masat e mëposhtme:

- Evidentimi dhe analizimi i zonave gjeografike, komuniteteve dhe grupeve shoqërore të afektuara dhe vulnerabël ndaj strukturave dhe veprimtarive të paligjshme;
- Koordinimi i nismave dhe mekanizmave të mbështetjes së brendshme dhe të huaj, në funksion të zhvillimit alternativ për zonat dhe komunitetet vulnerabël;
- Nxitja e programeve sociale me fokus shtresat në nevojë dhe viktimat e krimit përmes projekteve të financuara nga Fondi i Posaçëm për parandalimin e kriminalitetit;
- Nxitja e kalimit të objekteve të konfiskuara në pronësi të njësisive të qeverisjes vendore me qëllim përdorimin si banesa sociale.

5. Paraqitja tabelore e dokumentit strategjik

Qëllimi	Objektivi specifik	Veprimtari	Indikatorë	Afati	Institucione (përgjegjëse/m bështetës)	Buxheti
<i>Objektivi Strategjik 1: Ulja e kërcënimit dhe ndikimit të krimit të organizuar dhe krimeve të rënda</i>						

<p>1.1. <i>Ulja e veprimtarive të krimit të organizuar dhe krimeve të rënda</i></p>	<p>1.1.1. Goditja e veprimtarive kriminale në fushën e narkotikëve</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Rritja e veprimtarisë zbuluese të udhëhequr nga inteligjenca dhe evidencat - Përditësimi i bazës së të dhënave të posaçme për kultivimin e kanabisit me informacione nga të gjitha burimet e mundshme vendëse dhe të huaja - Planifikimi, organizimi dhe realizimi i takimeve, analizave dhe operacioneve të përbashkëta me qëllim të rritjes së zbulimit, hetimit, ndjekjes penale, dënimit dhe sekuestrimit në këtë drejtim - Forcimi i kontrollit kufitar për parandalimin dhe goditjen e trafikimit ndërkombëtar të drogave - Rritja e efikasitetit të bashkëpunimit me partnerët në drejtim të zbulimit të veprimtarive të paligjshme dhe goditjes së strukturave kriminale - Përmirësimi i kuadrit legjislativ për substancat psikotrope dhe prekursorët dhe përditësimi i listës së substancave të ndaluara psikoaktive - Përmirësimi i kuadrit legjislativ mbi procedurën e asgjësimit të lëndëve narkotike dhe prekursorëve dhe ruajtjes së mostrave - Ligji për barnat narkotike dhe lëndët psikotrope i rishikuar dhe lista e përditësuar e substancave të ndaluara psikoaktive (MSHMS, 2021) - Kuadri legjislativ mbi asgjësimin e lëndëve të ndaluara i përmirësuar 	<ul style="list-style-type: none"> - Numri i parcelave të kanabisit të identifikuara - Numri i mjediseve të mbyllura të kultivimit të kanabisit të identifikuara -Numri i bimëve të zbuluara dhe asgjësuar -Sasia e farës së kanabisit të zbuluar në kufi/territor - Numri i rasteve të identifikuara, zbuluara dhe referuara në prokurori -Sasia e heroinës së sekuestruar - Sasia e kokainës së sekuestruar - Sasia e drogave sintetike të sekuestruar - Numri i rasteve të identifikimit dhe zbulimit të përpjekjeve për trafikim ndërkombëtar të drogave - Sasia e drogave dhe prekursorëve të sekuestruara në vendet fqinje me origjinë/tranzit nga vendi ynë 	<p>6-mujore/ Vjetore</p>	<p>Inst. Përgjegjës</p> <p>Policia e Shtetit SHISH Doganat</p> <p>Inst. Mbështetës</p> <p>MSHMS PP AISM GdF/Projekti i mbështetur nga BE</p>	<p>2021:</p> <p>2022:</p> <p>2024:</p> <p>2025:</p> <p>Totali:</p>
---	--	--	--	--------------------------	--	--

	<p>1.1.2. Goditja e trafikeve të paligjshme</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Rritja e veprimtarisë zbuluese ndaj trafikeve të paligjshme të udhëhequr nga inteligjenca dhe evidencat - Planifikimi, organizimi dhe realizimi i takimeve, analizave dhe operacioneve të përbashkëta me qëllim rritjen e zbulimit, hetimit, ndjekjes penale, dënimit dhe sekuestrimeve dhe konfiskimeve në këtë drejtim - Forcimi i bashkëpunimit me partnerët në drejtim të zbulimit të veprimtarive të paligjshme dhe goditjes së strukturave kriminale - Përmirësimi dhe miratimi i procedurave dhe mekanizmave standard kundër trafikimit të armëve të vogla dhe të lehta - Hartimi dhe miratimi i Planit të Veprimit kundër Trafikimit të Veprave të Artit dhe Kulturës (Qershor 2021) - Ngritja dhe funksionimi i Task Forcës Ndërinstitucionale për Ruajtjen e Trashëgimisë Kulturore (2021) - Rishikimi i legjislacionit të brendshëm dhe ndryshimi në përputhje me instrumentet ndërkombëtare në fushën e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore. 	<ul style="list-style-type: none"> - Numri i referimeve/procedimeve penale të regjistruara në prokurori për trafikim të qenieve njerëzore - Numri i procedimeve penale të regjistruara në prokurori për dhënie të ndihmës për kalim të paligjshëm të kufirit - Numri i procedimeve penale të regjistruara në prokurori për trafikim të armëve, municioneve dhe eksplozivëve - Sasia e armëve, municioneve dhe eksplozivëve të sekuestruar - Veprimtari në kuadër të pjesëmarrjes në Ciklin e Politikave të BE/planin e veprimit operativ EMPACT - Numri i procedimeve penale të regjistruara në prokurori për trafikim të veprave të artit dhe kulturës - Procedurat dhe mekanizmat kundër trafikimit të armëve të vogla dhe të lehta të rishikuara dhe miratuara - Plani i Veprimit kundër Trafikimit të Veprave të Artit dhe Kulturës i miratuar - Task Forca Ndërinstitucionale për Veprat e Artit dhe Kulturës e ngritur dhe funksionale. 	<p>6-mujore/ Vjetore</p>	<p>Inst. Përgjegjës</p> <p>Policia e Shtetit</p> <p>Inst. Mbështetës</p> <p>MB MK AISM Doganat SHISH</p>	<p>2021:</p> <p>2022:</p> <p>2023:</p> <p>2024:</p> <p>2025:</p> <p>Totali:</p>
--	---	--	--	--------------------------	--	---

	<p>1.1.3. Ulja e krimit kibernetik</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Hartimi dhe miratimi i Planit të Veprimit kundër Krimit Kibernetik (Qershor 2021) - Vlerësimi dhe përafrimi i legjislacionit me acquis të BE, standardet dhe praktikat më të mira ndërkombëtare - Funkionimi dhe rritja e kapaciteteve logjistike dhe teknike të njësisë së specializuar për hetimin e krimeve kibernetike - Rritja e kapaciteteve logjistike dhe teknike në nivel lokal për hetimin e krimeve kibernetike - Pjesëmarrja aktive përmes pikave të kontaktit në platformat ndërkombëtare, përfshi rritjen e numrit dhe cilësisë së mesazheve të shkëmbyera me Europol - Rritja e ndërgjegjësimit midis prokurorëve mbi format e krimit kibernetik dhe përdorimin e rrjetit të Pikave të Kontaktit të Këshillit të Evropës 	<ul style="list-style-type: none"> - Miratimi i Planit të Veprimit kundër Krimit Kibernetik - Analiza e vlerësimit të kuadrit ligjor dhe rekomandimet për ndryshime - Pajisje dhe programe të avancuara të vëna në dispozicion të strukturave qendrore dhe vendore për hetimin e krimit kibernetik - Trajnime dhe numri i punonjësve të trajnuar - Veprimtari të realizuara në bashkëpunim me Rrjetin e Pikave të Kontaktit 24/7 të Këshillit të Evropës dhe projektet e Europol - Numri i trajnimeve dhe prokurorëve të trajnuar - Numri i veprave penale të krimit kibernetik të zbuluara dhe referuara në prokurori 	<p>Vjetore</p>	<p>Inst. Përgjegjës Policia e Shtetit</p> <p>Inst. Mbështetës AKCESK SHISH</p>	<p>2021:</p> <p>2022:</p> <p>2023:</p> <p>2024:</p> <p>2025:</p> <p>Totali:</p>
--	--	--	---	----------------	--	---

	<p>1.1.4. Goditja e krimit ekonomik dhe pastrimit të parave</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Zbatimi i masave të Planit të Veprimit në kuadër të rekomandimeve të ICRG/FATF - Forcimi i kapaciteteve të specializuara qendrore dhe vendore për hetimin e krimit ekonomik dhe financiar, duke përfshirë kryerjen e trajnimeve të përbashkëta - Sigurimi i aksesit dhe ndërveprimi online i bazave të të dhënave në funksion të mbikëqyrjes dhe hetimit në fushën ekonomike-financiare - Koordinimi dhe bashkëpunimi ndërinstitucional me qëllim rritjen e numrit të informacioneve të shkëmbyera mes strukturave përgjegjëse dhe kryerjen e analizave të thelluara mbi risqet e pastrimit të parave dhe administrimin e të dhënave (<i>track record</i>) - Përmirësimi i zbatimit të sanksioneve financiare të targetuara dhe hetimeve financiare proaktive dhe paralele që nga fillimi i procedimeve penale - Rritja e sekuestrimeve dhe konfiskimeve mbështetur në hetime cilësore të thelluara - Rishikimi dhe miratimi i kuadrit legjislativ mbi gjurmimin, sekuestrimin, konfiskimin dhe rikuperimin e produkteve të krimit të organizuar - Menaxhimi i pasurive të sekuestruara dhe konfiskuara duke ruajtur vlerën ekonomike të tyre 	<ul style="list-style-type: none"> - Objektivat dhe masat e parashikuara në Planin e Veprimit të realizuara deri në tetor 2021 - Struktura qendrore dhe vendore për hetimin e krimit ekonomik dhe financiar të riorganizuar në funksion të seksioneve të posaçme në prokurori - Numri i bazave të të dhënave të aksesueshme nga autoritetet e inteligjencës dhe hetimit financiar - Numri i analizave të përbashkëta të riskut (të targetuara/proaktive) - Numri i rasteve të referuara në prokurori të ndara sipas burimeve të informacionit - Numri i procedimeve të regjistruara në prokurori - Vlera e sekuestrimeve - Numri i vendimeve të pushimit - Numri i vendimeve për dërgim në gjyq - Numri i vendimeve për fajësi/pafajësi - Numri i vendimeve të formës së prerë - Vlera e konfiskimeve - Ligje dhe akte nënligjore të ndryshuara me qëllim rritjen e efikasitetit të hetimeve financiare dhe gjurmimit, ndjekjes, sekuestrimit, konfiskimit dhe rikuperimit të produkteve të krimit të organizuar (Ministria e Drejtësisë, 2021) - Numri dhe vlera e aseteve kriminale të sekuestruara dhe konfiskuara në administrim 	<p>6-mujore/ Vjetore</p>	<p>Inst. Përgjegjës</p> <p>Policia e Shtetit AAPSK MD</p> <p>Inst. Mbështetës</p> <p>SHISH DPT DPD DPPPP AMF AISM BSH QKB DHKA</p>	<p>2021:</p> <p>2022:</p> <p>2023:</p> <p>2024:</p> <p>Totali:</p>
--	---	--	--	--------------------------	--	--

<p>1.2. Goditja dhe shkatërrimi i strukturave të krimit të organizuar</p>	<p>1.2.1. Hetimi, ndjekja penale dhe dënimi i drejtuesve dhe anëtarëve të strukturave kriminale</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Rritja e efikasitetit të hetimeve kundër strukturave të organizuara kriminale, sidomos drejtuesve dhe financuesve të veprimtarive kriminale - Rritja e kapaciteteve teknike dhe logjistike përmes takimeve, analizave trajnimeve të përbashkëta dhe investimeve në funksion të hetimeve të thelluara, cilësore dhe proaktive kundër strukturave kriminale - Zgjerimi i aksesit dhe ndërveprimi i bazave të të dhënave publike/private të aksesueshme nga autoritetet përgjegjëse dhe zhvillimi dhe përdorimi i zgjeruar i kapaciteteve analitike (<i>software</i>) - Rritja e hetimeve ndaj metodave dhe rasteve të infiltrimit (korrupsioni, kërcënimet, etj) nga strukturat e krimit të organizuar - Përmirësimi i kuadrit legjislativ me qëllim rritjen e kapaciteteve të prokurorisë dhe agjencive të zbatimit të ligjit për luftën kundër kriminalitetit duke plotësuar rekomandimet e BE-së për sigurimin në kohë reale të të dhënave nga kompanitë telefonike 	<ul style="list-style-type: none"> - Numri i personave të referuar nga në prokurori për përfshirje në forma të veçanta të bashkëpunimit kriminal (N. 28, 284/a, 333, 333/a, 334 të Kodit Penal si dhe organizimi, drejtimi dhe financimi i veprimtarive të paligjshme të krimit të organizuar) - Numri i procedimeve përkatëse të regjistruara në prokurori - Numri i vendimeve përkatëse të pushimit - Numri i vendimeve për dërgim në gjyq - Numri i vendimeve për fajësi/pafajësi - Numri i vendimeve të formës së prerë - Numri i trajnimeve dhe analizave të përbashkëta - Numri i bazave të të dhënave publike dhe private të aksesueshme nga Policia, BKH, Prokurori/Prokurori e posaçme - Numri i referimeve, procedimeve dhe dënimeve për vepra penale kundër veprimtarisë shtetërore nga anëtarë të strukturave kriminale - Ligji nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar me qëllim ngritjen e kapaciteteve të policisë dhe prokurorisë për sigurimin në kohë reale të të dhënave nga kompanitë telefonike (identifikimi i pajtimtarit, kur dihet numri apo adresa e IP, identifikimi i pajisjeve apo adresave të IP për një pajtimtar të dhënë, dhe identifikimi i vendndodhjes së një pajisje fundore apo IP) - (Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Qershor 2021) 	<p>Vjetore</p>	<p>Inst. Përgjegjës</p> <p>Policia e Shtetit MB MD MIE</p> <p>Inst. Mbështetës</p> <p>SHISH</p>	<p>2021:</p> <p>2022:</p> <p>2023:</p> <p>2024:</p> <p>2025:</p> <p>Totali:</p>
---	---	--	---	----------------	---	---

	<p>1.2.2. Forcimi i bashkëpunimit policor ndërkombëtar</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Rritja e shkëmbimit të informacionit me agjencitë ligjzbatuese të vendeve të rajonit dhe më gjerë mbi strukturat kriminale brenda dhe jashtë vendit - Pjesëmarrja aktive në Europol, Interpol dhe platformat rajonale të bashkëpunimit - Nënshkrimi dhe zbatimi i marrëveshjeve me vendet e tjera për shkëmbimin e të dhënave (gjurmë daktiloskopike, profile ADN, të dhëna automjetesh, rekorde kriminale, të dhëna financiare, etj) - Rritja e operacioneve të përbashkëta policore kundër veprimtarive dhe strukturave kriminale 	<ul style="list-style-type: none"> - Numri i rasteve të shkëmbyera me autoritetet ligjzbatuese të vendeve të tjera për anëtarë/grupe të strukturara kriminale brenda dhe jashtë vendit - Numri i mesazheve dhe çështjeve të shkëmbyera përmes kanalit SIENA me Europol dhe shtetet anëtare - Numri i mesazheve të shkëmbyera me Interpol - Numri i marrëveshjeve dy dhe shumëpalëshe të nënshkruara në fushën e shkëmbimit të të dhënave në funksion të hetimit - Numri i operacioneve policore ndërkombëtare të realizuara kundër strukturave kriminale me veprimtari brenda dhe jashtë vendit 	<p>6-mujore/ Vjetore</p>		<p>2021:</p> <p>2022:</p> <p>2023:</p> <p>2024:</p> <p>2025:</p> <p>Totali:</p>
--	--	--	--	--------------------------	--	---

	1.2.3. Kapja e personave në kërkim ndërkombëtar	<ul style="list-style-type: none"> - Pjesëmarrja aktive në takimet dhe trajnimet e ENFAST - Rritja e shkëmbimit të të dhënave me vendet anëtare të ENFAST, Europol dhe Interpol - Rritja e numrit të shtetasve shqiptarë dhe të huaj në kërkim ndërkombëtar të lokalizuar dhe arrestuar - Publikimi dhe përditësimi i të dhënave të identitetit të personave në kërkim ndërkombëtar 	<ul style="list-style-type: none"> - Numri i takimeve dhe trajnimeve të përbashkëta të realizuara me ENFAST - Numri i të dhënave të shkëmbyera me ENFAST/vendet anëtare, Europol, Interpol - Numri i personave në kërkim ndërkombëtar të identifikuar, lokalizuar dhe arrestuar - Lista e publikuar dhe përditësuar e personave në kërkim ndërkombëtar - Numri i informacioneve të përcjella nga shërbimet e inteligjencës mbi personat në kërkim ndërkombëtar 	6-mujore/ Vjetore	Inst. Përgjegjës Policia e Shtetit Inst. Mbështetës SHISH	2021: 2022: 2023: 2024: 2025: Totali:
--	---	---	---	-------------------	--	--

	<p>1.2.4. Marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Rritja e marrëdhënieve juridiksionale me autoritetet e huaja - Përditësimi dhe aksesimi në regjistrin gjyqësor penal të shtetasve shqiptarë të dënuar jashtë shtetit - Mbështetja dhe rritja e pjesëmarrjes në skuadrat e përbashkëta hetimore (JIT-s dypalëshe/Eurojust) 	<ul style="list-style-type: none"> - Numri i marrëveshjeve dy dhe shumëpalëshe të nënshkruara me qëllim forcimin e marrëdhënieve juridiksionale me autoritetet e huaja (ekstradime, letërporositë, etj) - Numri i letërporosive të shkëmbyera me autoritetet e vendeve të tjera për anëtarë dhe veprimtari të krimit të organizuar - Numri i ekstradimeve të shtetasve shqiptarë dhe të huaj të përfshirë në veprimtari të krimit të organizuar dhe krimeve të rënda - Numri i vendimeve gjyqësore të huaja të njohura dhe ekzekutuara në vendin tonë për shtetas të dënuar për veprimtari të krimit të organizuar dhe krimeve të rënda - Numri i procedimeve penale të transferuara - Numri i personave të dënuar të transferuar brenda dhe jashtë vendit - Regjistri gjyqësor penal i shtetasve shqiptarë të dënuar jashtë shtetit i përditësuar dhe i aksesueshëm në kohë reale nga policia, BKH, prokuroria dhe prokuroria e posaçme - Numri i hetimeve të përbashkëta të mbështetura dhe nxitura nga përfaqësuesi i prokurorisë në Eurojust 	<p>Vjetore</p>	<p>Inst. Përgjegjës</p> <p>MD MEPJ</p> <p>Inst. Mbështetës</p> <p>PP Prokuroria e posaçme PSH BKH</p>	<p>2021:</p> <p>2022:</p> <p>2023:</p> <p>2024:</p> <p>2025:</p> <p>Totali:</p>
--	--	---	--	----------------	---	---

	1.2.5. Regjimi i posaçëm në burgun e sigurisë së lartë	- Zbatimi i regjimit të posaçëm në burgun e sigurisë së lartë	- Numri i të dënuarve dhe të paraburgosurve të vendosur në regjimin e posaçëm - Numri i dënuarve dhe të paraburgosurve për të cilët regjimi i posaçëm vazhdon më shumë se një vit	Vjetore	Inst. Përgjegjës MD DPB Inst. Mbështetës MB PP Prokuroria e posaçme SHISH	2021: 2022: 2023: 2024: 2025: Totali:
--	--	---	--	---------	---	--

Objektivi Strategjik 2: Mbrojtja e qytetarëve, institucioneve dhe ekonomisë

2.1. Garantimi i sigurisë fizike dhe jetës	2.1.1. Mbrojtja e shëndetit dhe jetës së dëshmitarëve, bashkëpunëtorëve, funksionarëve të drejtësisë dhe viktimave të trafikimit	- Garantimi i jetës dhe sigurisë fizike të dëshmitarëve, bashkëpunëtorëve të drejtësisë, funksionarëve të ngarkuar me luftën kundër krimit të organizuar dhe viktimave të trafikimit - Nënshkrimi dhe zbatimi i marrëveshjeve ndërkombëtare mbi programet e mbrojtjes së dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë - Nr i viktimave të trafikimit të asistuara	-Numri i dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë të pranuar në programet e mbrojtjes - Numri i dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë të pranuar të transferuar në programe të huaja të mbrojtjes - Numri i marrëveshjeve ndërkombëtare të nënshkruara mbi programet e mbrojtjes - Numri i funksionarëve të drejtësisë të pranuar në program mbrojtjeje - Numri i viktimave të trafikimit, përfshi të miturit ndaj të asistuara	Vjetore	Inst. Përgjegjës PSH Inst. Mbështetës MB KLP KLGJ	2021: 2022: 2023: 2024: 2025: Totali:
--	--	--	--	---------	--	--

<p>2.2.Përmirësim i kapaciteteve profesionale dhe logjistike</p>	<p>2.2.1.Garantimi i integritetit</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Vijimi dhe raportimi mbi vlerësimin kalimtar të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat - Parandalimi, zbulimi dhe hetimi i veprave penale dhe shkeljeve të ligjit të kryera nga punonjësit e strukturave gjatë ushtrimit të detyrës dhe për shkak të saj dhe ruajtja e integritetit të punonjësve të veçantë të strukturave, ndaj të cilëve referohen ankesa dhe kallëzime - Kryerja e veprimtarive dhe marrja e masave në funksion të ruajtjes së integritetit të punonjësve të strukturave 	<ul style="list-style-type: none"> - Numri i punonjësve, sipas gradave, të konfirmuar në detyrë nga organet e vlerësimit kalimtar dhe SHÇBA - Numri i punonjësve, sipas gradave, për të cilët është vendosur detyrimi për të ndjekur programin e trajnimit, sipas kurrikurave të miratuara nga Akademia e Sigurisë - Numri e vendimeve për përjashtimin nga detyra - Numri e vendimeve për detyrimin e titullarit të institucionit për emërimin në detyrë të ish-punonjësve - Numri i veprave penale dhe shkeljeve të ligjit të parandaluara, zbuluara dhe hetuara - Numri dhe emërtimi i veprimtarive dhe masave të marra në funksion të ruajtjes së integritetit të punonjësve të strukturave 	<p>6-mujore/ Vjetore</p>	<p>Inst. Përgjegjës</p> <p>Organet e vlerësimit / SHÇBA</p> <p>Inst. Mbështetës</p> <p>MB Inst. Publike dhe agjencitë e tjera ligjzbauese sipas nenit 54 të Ligjit Nr. 12/2018 datë 5.3.2018, i ndryshuar</p>	<p>2021:</p> <p>2022:</p> <p>2023:</p> <p>2024:</p> <p>2025:</p> <p>Totali:</p>
--	---------------------------------------	--	---	--------------------------	---	---

	<p>2.2.2.Rritja e profesionalizmit</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Kryerja e trajnimeve të strukturave të hetimit të krimit në Policinë e Shtetit mbi format dhe metodat më të avancuara të hetimit të strukturave dhe veprimtarive kriminale - Kryerja e trajnimeve të përbashkëta për punonjësit e agjencive të zbatimit të ligjit, shërbimeve inteligjente dhe funksionarëve të drejtësisë në funksion të hetimeve të thelluara dhe cilësore, ndjekjes penale, dënimit të autorëve dhe sekuestrimit/konfiskimit të produkteve dhe aseteve kriminale - Kryerja e trajnimeve për punonjësit e agjencive të zbatimit të ligjit, funksionarët e drejtësisë dhe stafet administrative për çështje të bashkëpunimit policor/gjyqësor ndërkombëtar - Kryerja e trajnimeve për punonjësit e agjencive të zbatimit të ligjit, gjyqtarëve dhe prokurorëve mbi rolin e viktimave në drejtësinë penale - Pranimi në Akademinë e Sigurisë i të diplomuarve që kanë përfunduar ciklin e dytë të arsimit të lartë 	<ul style="list-style-type: none"> - Trajnime të realizuara dhe numri i punonjësve përfitues nga strukturat e hetimit të krimit në Policinë e Shtetit, duke respektuar dhe përfaqësimin gjinor - Numri dhe emërtimi i trajnimeve të përbashkëta të realizuara midis agjencive të zbatimit të ligjit, shërbimeve të inteligjencës dhe funksionarëve të drejtësisë mbi çështje të bashkëpunimit ndërkombëtar në nivel policor dhe gjyqësor si dhe rolin e viktimave në proceset penale - Numri i të diplomuarve që kanë përfunduar ciklin e dytë të arsimit të lartë në shkencat juridike, shkencat ekonomike (degët ekonomi, financë) ose shkencat kompjuterike (degët informatikë, elektronikë) të pranuar në Akademinë e Sigurisë - Numri i kandidatëve që kanë përfunduar me sukses kualifikimin përkatës të pranuar në Policinë e Shtetit me gradën “Nënkomisar”, sipas përcaktimeve të nenit 37, pika 3 e Ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar. 	<p>Vjetore</p>	<p>Inst. Përgjegjës</p> <p>MB DPSH</p> <p>Inst. Mbështetës</p> <p>MD KLGJ KLP Shkolla e Magjistraturës</p>	<p>2021:</p> <p>2022:</p> <p>2023:</p> <p>2024:</p> <p>2025:</p> <p>Totali:</p>
--	--	--	--	----------------	--	---

	<p>2.2.3. Investime dhe mbështetja logjistike</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Ngritja dhe funksionimi i Sistemit të Paralajmërimit të Hershëm (EWS) dhe Observatorit Kombëtar të Drogave - Magazinimi dhe asgjesimi i lëndëve narkotike dhe prekursorëve dhe ruajtja e mostrave si provë materiale për procedurat gjyqësore sipas standardeve dhe praktikave më të mira - Përmirësimi i bazës logjistike të Institutit të Policisë Shkencore dhe ofrimi i trajnimeve mbi ekzaminimet e lëndëve narkotike dhe prekursorëve - Hartimi i projekteve, përthithja e financimeve dhe koordinimi i projekteve për mbështetjen e kapaciteteve njerëzore, infrastrukturore dhe logjistike të agjencive të zbatimit të ligjit 	<ul style="list-style-type: none"> - Sistemi i Paralajmërimit të Hershëm (PSH, 2021) dhe Observatori Kombëtar i drogave funksional (MSHMS 2022) - Laboratori për analizën e përmbajtjes së cannabidiolit, cannabionolit dhe tetrahidrocannabinolit (THC) i ngritur dhe funksional - Sigurimi dhe funksionimi i logjistikës së nevojshme për administrimin dhe shkatërrimin e drogave dhe ruajtja e mostrave sipas procedurave të rishikuara - Numri i projekteve të propozuara/siguruar mbështetje financiare dhe atyre në fazën zbatuese për mbështetjen dhe rritjen e kapaciteteve - Vlera e investimeve sipas objektivave/strukturave përkatëse 	<p>Vjetore</p>	<p>Inst. Përgjegjës</p> <p>MSHMS MB DPSH IPSH</p> <p>Inst. Mbështetës</p> <p>MFE MEPJ</p>	<p>2021:</p> <p>2022:</p> <p>2023:</p> <p>2024:</p> <p>2025:</p> <p>Totali:</p>
--	---	--	---	----------------	---	---

<p><i>2.3.Dobësimi i motivit financiar për përfshirje në krim të organizuar</i></p>	<p>2.3.1 Zbatimi i qasjes parandaluese me karakter pasuror dhe ekonomik ndaj subjekteve të lidhur me veprimtari të krimit të organizuar dhe krimet e rënda</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Analizë e legjislacionit, politikave dhe rolit të institucioneve dhe agjencive të zbatimit të ligjit në funksion të masave parandaluese me karakter ekonomik dhe pasuror - Evidentimi i mangësive dhe nevojave për përmirësim të kuadrit ligjor parandalues - Hartimi dhe miratimi i ndryshimeve ligjore dhe nënligjore në funksion të rritjes së parandalimit të investimit të të ardhurave kriminale në ekonomi - Kryerja e trajnimeve, analizave dhe koordinimi ndërinstytucional në zbatim të masave parandaluese pasurore - Rritja e aksesit dhe ndërveprimi në bazat e të dhënave publike dhe private për shqyrtimin e aplikimeve për leje, autorizime, licensa, etj. 	<ul style="list-style-type: none"> - Analiza e kuadrit ligjor dhe situatës mbi masat parandaluese me karakter pasuror/ekonomik e kryer (2021) - Ndryshimet ligjore dhe nënligjore në funksion të rritjes së masave parandaluese me karakter ekonomik ndaj krimit të organizuar të hartuara dhe miratuara (2021) - Udhëzimi mbi procedurat e shkëmbimit, verifikimit dhe shqyrtimit të aplikimeve në funksion të zbatimit të masave parandaluese ekonomike ndaj subjekteve të përfshirë në veprimtari të krimit të organizuar dhe krimeve të rënda, i miratuar (MB, MFE, MD - 2021) - Regjistri i masave parandaluese funksional dhe i përditësuar në Policinë e Shtetit (Mars 2022) 	<p>Vjetore</p>	<p>Inst. Përgjegjës</p> <p>MSHMS MB DPSH IPSH</p> <p>Inst. Mbështetës</p> <p>MFE MEPJ</p>	<p>2021:</p> <p>2022:</p> <p>2023:</p> <p>2024:</p> <p>2025:</p> <p>Totali:</p>
---	--	---	---	----------------	---	---

Objektivi Strategjik 3: Parandalimi

<p>3.1 Rritja e vetëdijësimit për risqet dhe pasojat e krimit të organizuar</p>	<p>3.1.1 Realizimi i fushatave për rritjen e ndërgjegjësimit me përfshirjen e institucioneve qendrore dhe vendore, shoqërisë civile, biznesit, medias dhe aktorëve të tjerë për parandalimin e krimit të organizuar</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Organizimi i fushatave ndërgjegjësuese në nivel qendror dhe vendor, me grupe të targetuara dhe tema të përshtatura me kontekstin vendor lidhur me risqet, pasojat dhe parandalimin e përfshirjes në veprimtari kriminale. - Organizimi i leksioneve dhe seminareve të hapura në mjedise arsimore publike dhe private - Realizimi i video-mesazheve ndërgjegjësuese mbi risqet dhe pasojat e krimit të organizuar si dhe promovimi i modeleve pozitive ndërmjet të rinjve dhe transmetimi në mediet lokale, rrjete sociale, etj - Organizimi i takimeve të Këshillave Vendorë për Siguri Publike me të ftuar nga shoqëria civile, të rinj, aktorë kyç në komunitete me fokus rritjen e vetëdijësimit ndaj krimit të organizuar 	<ul style="list-style-type: none"> - Numri dhe tematika e fushatave ndërgjegjësuese në nivel vendor të realizuara - Numri i orëve të leksioneve/seminare të hapura të realizuara në mjedise arsimore me të ftuar/pjesëmarrjen e punonjësve të DVP - Numri i video-mesazheve ndërgjegjësuese të realizuara dhe transmetuara - Numri i takimeve të Këshillave Vendorë për Siguri Publike me fokus rritjen e vetëdijësimit ndaj risqeve dhe pasojave të krimit të organizuar 	<p>Vjetore</p>	<p>Inst. Përgjegjës</p> <p>MB DPSH</p>	2021:
					<p>Inst. Mbështetës</p>	2022:
					<p>MASR Prefekti i Qarkut</p>	2023:
						2024:
						2025:
						Totali:

<p>3.3 Zhvillimi alternativ</p>	<p>3.3.1 Ofrimi dhe koordinimi i mbështetjes së brendshme/huaj për zona dhe komunitete vulnerabël</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Evidentimi dhe analizimi i zonave gjeografike, komuniteteve dhe grupeve shoqërore të afektuara dhe vulnerabël ndaj strukturave dhe veprimtarive të paligjshme - Koordinimi i nismave dhe mekanizmave të mbështetjes së brendshme dhe të huaj, në funksion të zhvillimit alternativ për zonat dhe komunitetet vulnerabël - Nxitja e programeve sociale me fokus shtresat në nevojë dhe viktimat e krimit përmes projekteve të financuara nga Fondi i Posaçëm për parandalimin e kriminalitetit - Nxitja e kalimit të objekteve të konfiskuara në pronësi të njërive të qeverisjes vendore me qëllim përdorimin si banesa sociale 	<ul style="list-style-type: none"> - Harta e zonave gjeografike të afektuara ndër vite dhe me potencial ekspozimi ndaj veprimtarive të paligjshme si kultivimi i kanabisit, etj (MB/PSH) - Udhëzim i përbashkët i Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Minsitrit të Turizimit dhe Mjedisit dhe Ministrit të Brendshëm mbi zhvillimin rural dhe turistik të zonave të afektuara nga veprimtaritë e paligjshme (2021) - Numri dhe vlera e projekteve me financim të brendshëm për nxitjen e zhvillimit bujqësor, turistik etj në zona dhe komunitete të afektuara nga veprimtari të paligjshme (Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Mjedisit) - Numri dhe vlera e projekteve me financim të huaj për nxitjen e zhvillimit bujqësor, turistik etj në zona dhe komunitete të afektuara nga veprimtari të paligjshme (Ministria e Brendshme) - Numri dhe vlera e projekteve me karakter social të mbështetura nga Fondi i posaçëm për parandalimin e kriminalitetit - Numri i objekteve të konfiskuara të kaluara në pronësi dhe përdorim të njërive të qeverisjes vendore për banesa sociale (Ministria e Brendshme) 	<p>Vjetore</p>	<p>Inst. Përgjegjës</p> <p>MB MBZHR MTD DPSH</p> <p>Inst. Mbështetës</p> <p>FZHR Bashkitë Prefekti i Qarkut Donatorë</p>	<p>2021:</p> <p>2022:</p> <p>2023:</p> <p>2024:</p> <p>2025:</p> <p>Totali:</p>
---------------------------------	---	--	--	----------------	--	---

6. Zbatimi, monitorimi dhe vlerësimi

Zbatimi i objektivave strategjike dhe objektivave specifike do të monitorohet rregullisht përmes të dhënave të raportuara, gjeneruara dhe vlerësuara përmes Sistemit Informativ për Planifikimin Strategjik të Integruar (IPSIS) në Këshillin e Ministrave.

Mbështetur në instrumente të tjera si raporte dhe të dhëna të institucioneve të përfshira, anketa, etj, Ministria e Brendshme do të kryejë gjithashtu vlerësime vjetore të karakterit cilësor mbi përmbushjen e qëllimeve strategjike dhe objektivave specifike të parashikuara në këtë dokument. Për këtë qëllim si dhe për të trajtuar çështje të posaçme në interes të përmbushjes së qëllimeve strategjike dhe objektivave të parashikuara në këtë dokument, mund të mblidhet Komiteti Kombëtar i Koordinimit për Parandalimin dhe Luftën Kundër Krimit të Organizuar (KKKO).

7. Burimet financiare

Burimet financiare për zbatimin e SKKOKR 2021 - 2025 sigurohen nga buxheti i shtetit, donatorët partnerë të Qeverisë Shqiptare, Ministrisë së Brendshme, ministrive të linjës dhe institucioneve të tjera të përfshira në zbatim.

Për aktivitete të planit të veprimit të pambuluara financiarisht, institucionet përgjegjëse do të planifikojnë nevojat për financime buxhetore nëpërmjet programeve buxhetore përkatëse, si pjesë e procesit të planifikimit të Programit Afatmesëm Buxhetor dhe buxhetit vjetor.

8. Përgjegjësia e institucioneve

Institucionet përgjegjëse për zbatimin e Strategjisë kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2021-2025 dhe Planit të Veprimit 2021-2022 janë:

- 1- Ministria e Brendshme
- 2- Ministria e Drejtësisë;
- 3- Ministria e Mbrojtjes;
- 4- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë;
- 5- Ministria e Kulturës;
- 6- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
- 7- Ministria e Financave dhe Ekonomisë;
- 8- Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë;

- 9- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;
- 10- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit;
- 11- Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;
- 12- Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar;
- 13- Këshilli i Lartë Gjyqësor;
- 14- Këshilli i Lartë i Prokurorisë;
- 15- Prokuroria e Përgjithshme;
- 16- Shërbimi Informativ i Shtetit;
- 17- Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kombëtare;
- 18- Bashkitë;
- 19- Prefekturat.